

Nr.135 Prot

Tiranë, 06/02/2026

Drejtuar: Z. Blendi Goxhja

Ministër i Turizmit, Kulturës dhe Sportit

Lënda: Thirrje 2026 / Aktivitete Sportive me Karakter Ndërkombëtar me Impakt, Social, Kulturor, Ekonomik dhe Turistik në Vend / EUC Combat Sports Tirana 2026

I nderuar z. Blendi Goxhja

Në vijim të Vendimit Nr. 830, datë 30.12.2025, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për financimin e aktiviteteve sportive me karakter ndërkombëtar me impakt social, kulturor, ekonomik dhe turistik në vend, në rastet kur zhvillohen në territorin e Republikës së Shqipërisë”, Federata Shqiptare e Sportit Universitar (FSHSU) paraqet këtë kërkesë për mbështetje financiare për organizimin e Kampionatit European Universitar të Sporteve Luftarake – EUC Combat Sports Tirana 2026, që do të zhvillohet në Tiranë, në datat 7–12 shtator 2026.

Kampionati Evropian Universitar i Sporteve Luftarake – EUC Combat Tirana 2026” synon organizimin e një eventit sportiv European në Tiranë, në periudhën 7–12 shtator 2026, sipas standardeve dhe kërkesave të European University Sports Association (EUSA). Kampionati do të zhvillohet njëkohësisht në disiplinat Judo, Taekwondo, Karate dhe Kickboxing, në ambiente të miratuara dhe me mbështetje të gjerë institucionale.

Projekti adreson nevojën për rritjen e kapaciteteve kombëtare në organizimin e eventeve evropiane, duke u mbështetur mbi një traditë të gjatë të sportit universitar në Shqipëri dhe mbi transformimin e viteve të fundit, ku FSHSU ka arritur të përfshijë mbi 13,000 studentë në aktivitete sportive universitare, duke promovuar barazinë gjinore, përfshirjen sociale dhe një kulturë aktive brenda universiteteve.

FSHSU ka dëshmuar kapacitete konkrete organizative dhe ndërkombëtare, organizimin e suksesshëm të European University Football Championship në vitin 2023, si dhe pjesëmarrjen e konsoliduar në aktivitetet e EUSA, përfshirë angazhimin e delegacioneve dhe vullnetarëve në EUC Combat 2025, ku FSHSU mori zyrtarisht flamurin e organizimit të EUC Combat 2025 dhe u vlerësua me letër mirënjohjeje nga Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i EUSA.

Projekti bazohet në një strukturë menaxheriale funksionale, master plan zyrtar, planifikim të detajuar logjistik, skema të kontrollit financiar, menaxhim risku, trajnimin e stafit dhe vullnetarëve (përfshirë Akademinë e Vullnetarëve), si dhe sisteme monitorimi/raportimi. Në aspektin institucional, mbështetja është e konfirmuar nga ministria përgjegjëse (në zbatim të Ligjit Nr.

79/2017), nga Bashkia Tiranë dhe nga universitetet, ndërsa në aspektin sportiv-teknik projekti garanton standardet përmes angazhimit të federatave sportive përkatëse.

Ambientet sportive ku do të zhvillohet kampionati janë:

1. Pallati i Sportit Feti Borova, Parku Olimpik
2. Salla e Lojërave të Universitetit të Sporteve
3. Shkolla 9-vjeçare Qazim Turdiu
4. Salla e Lojërave e Akademisë së Sigurisë / Akademia Goga Basket

Projektit i jepet garanci e shtuar realizueshmërie nga mbështetja e konfirmuar e ministrisë dhe mekanizmat e mbikëqyrjes ndërinstucionale;

Mbështetja në natyrë e Bashkisë Tiranë (akomodim falas për mbi 1,300 pjesëmarrës për 5 net, përdorim ambientesh, ceremoni hapjeje në shesh publik, shërbime bashkiake);

Mbështetja e Universitetit të Tiranës dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë;

Mbështetja teknike e federatave sportive dhe miratimet e delegatëve teknikë të EUSA për ambientet dhe standardet.

Sa më sipër, ju parashtrajmë kërkesën për mbështetje financiare në vlerën 170,000 (njëqind e shtatëdhjetë mijë) euro, për mbulimin e kostove të burimeve njerëzore, gjyqtarëve ndërkombëtar dhe *tarifës* së atribuimit:

Përshkrimi	Sasia	Njësia	Njësia kohore	Kosto individuale	EUR
I. Burimet Njerëzore					€ 97,000.00
1.1. Menaxher i Përgjithshëm - Autor Kryesor i Projektit dhe Master-Planit	1	person	10 muaj	€ 1,200.0	€ 12,000.0
1.2. Menaxher i Përgjithshëm i Eventit	1	person	10 muaj	€ 1,000.0	€ 10,000.0
1.3. Drejtor Ekzekutiv	1	person	6 muaj	€ 1,000.0	€ 6,000.0
1.4. Delegat Teknik	4	person	1 muaj	€ 550.0	€ 2,200.0
1.5. Drejtor i Vendeve të Ngjarjeve	4	person	1 muaj	€ 450.0	€ 1,800.0
1.6. Drejtor i Akomodimit	2	person	1 muaj	€ 600.0	€ 1,200.0
1.7. Drejtor i Ushqimit	2	person	1 muaj	€ 600.0	€ 1,200.0
1.8. Drejtor i Transportit	1	person	1 muaj	€ 1,000.0	€ 1,000.0
1.9. Drejtor Mjekësor	4	person	5 ditë	€ 100.0	€ 2,000.0
1.10. Drejtor i Marketingut	1	person	6 muaj	€ 1,200.0	€ 7,200.0
1.11. Drejtor i Protokollit dhe VIP	1	person	2 muaj	€ 550.0	€ 1,100.0
1.12. Drejtor i Vullnetarëve	1	person	6 muaj	€ 550.0	€ 3,300.0
1.13. Koordinator i Vullnetarëve	4	person	15 ditë	€ 120.0	€ 7,200.0
1.13. Atashe	27	person	5 ditë	€ 90.0	€ 12,150.0



FSHSU

Federata Shqiptare e Sportit Universitar

1.14. Drejtor i Medias dhe PR	1	person	6 muaj	€ 650.0	€ 3,900.0
1.15. Menaxher i Financave	1	person	8 muaj	€ 750.0	€ 6,000.0
1.16. Drejtor i IT-së	1	person	6 muaj	€ 700.0	€ 4,200.0
1.17. Menaxher i Logjistikës	1	person	3 muaj	€ 750.0	€ 2,250.0
1.18. Akreditim	10	person	1 muaj	€ 750.0	€ 7,500.0
1.19. Asistent VIP	5	person	1 muaj	€ 500.0	€ 2,500.0
1.20. Menaxher i Eventeve Sociale	1	person	1 muaj	€ 1,100.0	€ 1,100.0
1.21. Moderator	1	person	1 muaj	€ 1,200.0	€ 1,200.0
					€ 33,000.0
2.1. Gjyqtarë	110	person	3 ditë	€ 100.0	€ 33,000.0
					€ 40,000.0
3.1. Karate					€ 10,000.0
3.2. Taekwondo					€ 10,000.0
3.3. Kickboxing					€ 10,000.0
3.4. Judo					€ 10,000.0
TOTAL					€ 170,000.0

Duke ju falënderuar për vëmendjen dhe bashkëpunimin tuaj, mbetemi në dispozicion për çdo informacion apo sqarim të mëtejshëm.

Me respekt,

Besnik Veliu

PRESIDENT

